

# **PROTOKOLLI I DYTË FAKULTATIV I PAKTIT NDËRKOMBËTAR PËR TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE**

**Miratuar dhe shpallur nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 44/128 të datës 15 dhjetor 1989**

*Shtetet palë të këtij Protokolli,*

*Duke besuar se heqja e dënimit me vdekje kontribuon në respektimin e dinjitetit të njeriut dhe në zhvillimin progresiv të të drejtave të njeriut,*

*Duke rikujtuar nenin 3 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut të miratuuar më 10 dhjetor të vitit 1948 dhe nenin 6 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike të miratuuar më 16 dhjetor të vitit 1966,*

*Duke vërejtur se neni 6 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike ka të bëjë me heqjen e dënimit me vdekje në mënyrën që fuqimisht sugjeron heqjen e këtij dënimi,*

*Të bindura se të gjitha masat e marra për heqjen e dënimit me vdekje duhet të konsiderohen si përparim i mbrojtjes së të drejtës për jetë,*

*Duke dashur që me këtë të marrin përsipër një obligim ndërkombëtar për heqjen e dënimit me vdekje,*

*U morën vesh për sa vijon:*

## **Neni 1**

1. Askush nuk duhet të ekzekutohet brenda juridiksionit të një shteti palë të këtij Protokolli.

2. Çdo shtet palë do të marrë të gjitha masat e nevojshme për heqjen e dënimit me vdekje brenda juridiksionit të tij.

## **Neni 2**

1. Asnjë rezervë e shprehur ndaj këtij Protokolli, nuk është e pranueshme me përjashtim të rezervës që është shprehur në çastin e ratifikimit ose të aderimit e cila mundëson zbatimin e dënimit me vdekje në kohën e luftës në përputhje me dënimin që është dhënë për krimin më serioz të natyrës ushtarake të kryer gjatë kohës së luftës.

2. Shteti palë që ka shprehur një rezervë të tillë, në kohën e ratifikimit ose të aderimit, do t'ia komunikojë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të

Bashkuara dispozitat e rëndësishme të legjislacionit të vet kombëtar të aplikueshme gjatë kohës së luftës.

3. Shteti palë që ka shprehur një rezervë të tillë do ta njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara lidhur me çfarëdo fillimi ose përfundimi të gjendjes së luftës të aplikueshme në territorin e vet.

### **Neni 3**

Shtetet palë të këtij Protokolli, në raportin që ia dërgojnë Komitetit për të Drejtat e Njeriut, në përputhje me nenin 40 të Paktit, përfshijnë informacionin lidhur me masat që i kanë miratuar për plotësimin e detyrimeve që i kanë marrë përsipër me këtë Protokoll.

### **Neni 4**

Lidhur me shtetet palë të Paktit të cilat kanë dhënë deklaratën sipas nenin 41, kompetenca e Komitetit për të Drejtat e Njeriut për të marrë dhe shqyrtuar komunikimet kur një shtet palë pretendon se një shtet tjetër palë nuk përmbush detyrimet e veta do të zgjerohet edhe për dispozitat e këtij Protokolli përveç nëse shteti palë përkatës nuk ka deklaruar të kundërtën në çastin e ratifikimit ose të aderimit.

### **Neni 5**

Lidhur me shtetet palë të Protokollit të Parë Fakultativ të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike të miratuar më 16 dhjetor të vitit 1966, kompetenca e Komitetit për të Drejtat e Njeriut për të marrë dhe shqyrtuar komunikimet nga individët që i nënshtrohet juridiksionit të tij do të zgjerohet edhe për dispozitat e këtij Protokolli përveç nëse shteti palë përkatës nuk ka deklaruar të kundërtën në çastin e ratifikimit ose të aderimit.

### **Neni 6**

1. Dispozitat e këtij Protokolli do të zbatohen si dispozita plotësuese të Paktit.
2. Pa cenuar mundësinë e shprehjes së rezervës në përputhje me nenin 2 të këtij Protokolli, e drejta e garantuar në nenin 1, paragrafin 1, të këtij Protokolli nuk do t'i nënshtrohet asnjë shmangie në përputhje me nenin 4 të Paktit.

### **Neni 7**

1. Ky Protokoll është i hapur për nënshkrimin e çdo shteti që ka nënshkruar Paktin.

2. Ky Protokoll i nënshtrohet ratifikimit nga çdo shtet që ka ratifikuar Paktin ose që ka aderuar në të. Instrumentet e ratifikimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

3. Ky Protokoll do të jetë i hapur për aderimin e çdo shteti që ka ratifikuar Paktin ose që ka aderuar në të.

4. Aderimi do të bëhet nëpërmjet depozitimit të një instrumenti të aderimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

5. Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara informon të gjitha shtetet që kanë nënshkruar këtë Protokoll ose që kanë aderuar në të, për çdo instrument të ratifikimit ose të aderimit që depozitohet.

### **Neni 8**

1. Ky Protokoll hyn në fuqi tre muaj pas ditës së depozitimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara të instrumentit të dhjetë të ratifikimit ose të aderimit.

2. Për çdo shtet që do të ratifikojë këtë Protokoll ose që do të aderojë në të pas depozitimit të instrumentit të dhjetë të ratifikimit ose të aderimit, ky Protokoll do të hyjë në fuqi tre muaj pasi ky shtet ta ketë depozituar instrumentin e tij të ratifikimit ose të aderimit.

### **Neni 9**

Dispozitat e këtij Protokoll janë të zbatueshme, pa asnjë kufizim dhe përjashtim, për të gjitha njësitë konstitutive të shteteve federative.

### **Neni 10**

Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara do t'i informojë të gjitha shtetet e përmendura në nenin 48, paragrafi 1, të Paktit:

- (a) Për rezervat e shprehura, komunikimet dhe njoftimet në përputhje me nenin 2 të këtij Protokoll;
- (b) Për deklaratat e dhëna në përputhje me nenet 4 ose 5 të këtij Protokoll;
- (c) Për nënshkrimet, ratifikimet dhe aderimet në përputhje me nenin 7 të këtij Protokoll ;
- (ç) Për datën kur ky Protokoll do të hyjë në fuqi në përputhje me nenin 8.

### **Neni 11**

1. Ky Protokoll, tekstet e të cilit në gjuhët arabe, kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle janë njësoj autentike, do të depozitohet në arkivat e Kombeve të Bashkuara.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara do t'u dërgojë nga një kopje të vërtetuar të këtij Protokollit të gjitha shteteve të përmendura në nenin 48 të Paktit.

(Unofficial version, 19 June, 2003)